



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

---

## RAPORT ME REKOMANDIME

### I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Rasti A. nr. 555/2020

në lidhje me

*me refuzimin e kërkesës së z. Tienmu Ma për leje qëndrimi në Republikën e Kosovës*

#### Drejtuar:

- Z. Avdullah Hoti, kryeministër i Republikës së Kosovës
- Z. Agim Veliu, ministër i Punëve të Brendshme
- Z. Agron Gashi, kryesues i Komisionit të Ankesave për të Huajt

Prishtinë, më 30 tetor 2020

## QËLLIMI I RAPORTIT

1. Qëllimi i këtij raporti është paraqitja e konstatimeve dhe e rekomandimeve të Avokatit të Popullit për autoritetet publike përgjegjëse, përkritazi me shkeljen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit, lidhur me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes së kërkesës së z. Tienmu Ma për leje qëndrimi në Republikën e Kosovës.

## BAZA LIGJORE

2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 1, përcakton: “*Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.*”
3. Neni 135, paragrafi 3, përcakton: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”
4. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - “*Avokati i Popullit ka kompetencë për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.*” (neni 16, paragrafi 1);
  - “*të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.*” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 2);
  - “*të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.*” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 5);
  - “*t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.*” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 6);
  - “*të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo **ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative (theks i shtuar)** nga institucionet e Republikës së Kosovës.*” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 7).
5. Me dërgimin e këtij raporti tek autoritetet publike përgjegjëse si dhe publikimin e tij në media, Avokati i Popullit synon t’i kryejë këto përgjegjësi ligjore.



## PËRSHKRIMI I RASTIT

6. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 27 shtator 2020, e ka pranuar ankesën e z. Tienmu Ma, shtetas amerikan (në tekstin e mëtejme: ankuesi), përkitazi me veprimet e autoriteteve përkatëse lidhur me trajtimin e kërkesës së tij për leje qëndrimi në Republikën e Kosovës. Ankuesi pretendon se veprimet e autoriteteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës paraqesin shkelje të të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore.
7. Kuptohet se më 30 mars 2020, Ministria e Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejme: MPB) ka nxjerrë *Vendim nr. 159/2020 për shtyrje dhe pezullim të afateve në procedurë administrative dhe vazhdim të leje dhe licensave*.
8. Megjithatë, ankuesi, më 7 prill 2020, ka paraqitur kërkesë për leje qëndrimi në Republikën e Kosovës, në MPB – Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim – Divizioni për të Huajt, për shqyrtimin e leje qëndrimit për të huajt.
9. Ankuesi më tej ka njoftuar se më 29 prill 2020, ka pasur një komunikimin nëpërmjet postës elektronike me zyrtarët e Divizionit për të Huajt i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim, në kuadër të MPB-së, me ç’ rast ai është njoftuar: “*Nese mometalisht nuk mund ti plotesoni këto kritere ligjore, ju mund te qendroni edhe me tutje me kete status (pra vetem me paraqitje te kerkeses) duke u thirrur ne Vendimin Nr.159 i dates 30.03.2020 i nxerre nga UD.Ministri i MPBAP-se, me te cilin jane zgjatur te gjitha afatet per rregullimin e dokumentacionit per te huajt dhe qendrimin e tyre brenda territorit te Republikes se Kosoves.*” Si dëshmi, ankuesi ka ofruar kopjen e e-mailit dërguar atij nga udhëheqësi i Divizionit për të Huajt dhe qëndrimin e tyre brenda territorit të Republikë së Kosovës.
10. Për më shumë, ankuesi ka njoftuar se më 6 korrik 2020 ka pasur një tjetër komunikim me zyrtarët e Divizionit për të Huajt i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim, në kuadër të MPB-së, me ç’ rast është njoftuar: “*Ne mungesë te dokumentacionit, si dhe bazuar në Vendimin e Qeverisë 159/2020 për pezullimin dhe zgjatjen e afateve, ne nuk kemi marr asnjë vendim.*” Si dëshmi ankuesi ka ofruar kopjen e e-mailit të cilin e ka marrë nga, zyrtari për të Huajt i Divizionit për të Huajt.
11. Kuptohet se më 6 korrik 2020, ministri i MPB dhe koordinatori i Grupit Ndërinstitucional për Menaxhimin e Incidenteve kanë nxjerrë *Vendim nr. 731/2020 për shtyrje dhe pezullim të afateve në procedurë administrative dhe vazhdim të leje dhe licensave*, me të cilin është shfuqizuar Vendimi nr.159/2020, i datës 30 mars 2020.
12. Më 20 gusht 2020, MPB – Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim – Divizioni për të Huajt, si organi administrativ i shkallës së parë, ka nxjerrë Vendimin nr. 02224/2020, me të cilin ankuesit i është refuzuar kërkesa për leje qëndrimi. Ndërsa më 21 gusht 2020, po i njëjti organ ka nxjerrë Vendimin nr. 00174/2020 për largim vullnetar nga Republika e Kosovës.
13. Më 2 shtator 2020, ankuesi ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave për të



- Huajt, me të cilën ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve të organit të shkallës së parë.
14. Më 21 shtator 2020, Komisioni i Ankesave për të Huajt ka nxjerrë Vendimin nr. 116/2020, me të cilin ia ka refuzuar ankesën e z. Ma, duke i lënë në fuqi vendimet e organit të shkallës së parë.
  15. Avokati i Popullit, më 1 tetor 2020, pas shqyrtimit të ankesës ka vlerësuar se ankuesi mund të pësonte dëme të pariparueshme dhe ka kërkuar nga kryeministri i Republikës së Kosovës *pezullimin* e vendimeve të theksuara më sipër, deri në përfundimin e hetimeve nga Avokati i Popullit.
  16. Më 9 tetor 2020, kryeministri i Republikës së Kosovës e ka njoftuar Avokatin e Popullit se e ka pezulluar ekzekutimin e Vendimit Nr.116/2020 të Komisionit të Ankesave për të Huajt, si Vendimin Nr. 02224/20 dhe Vendimin Nr. 00174/20 të Ministrisë së Punëve të Brendshme – Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim – Divizioni për të Huajt, deri në përfundimin e hetimeve nga Avokati i Popullit.
  17. Më 13 tetor 2020, Avokati i Popullit ia ka dërguar një shkresë ministrit të MPB-së, me ç’ rast ka kërkuar informata nëse *Vendimi nr.731/2020* (i datës 6 korrik 2020) *për shtyrje dhe pezullim të afateve në procedurë administrative dhe vazhdim të lejeve dhe licensave* është akoma në fuqi dhe nëse i njëjti ka qenë në fuqi edhe në kohën kur MPB – Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim – Divizioni për të Huajt ishte duke e trajtuar kërkesën e z. Ma për leje qëndrimi të përkohshëm. Po ashtu, Avokati i Popullit ka kërkuar informata nëse brenda kësaj periudhe është trajtuar ndonjë rast tjetër përveç rastit të z. Ma, lidhur me kërkesa për leje qëndrimi, përkatësisht prej datës 6 korrik 2020 e tutje, dhe nëse palëve u është kërkuar plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm për lejimin apo vazhdimin e leje qëndrimit të përkohshëm.
  18. Më 16 tetor 2020, ministri i MPB-së ka njoftuar se *Vendimi nr.731/2020* (i datës 6 korrik 2020) *për shtyrje dhe pezullim të afateve në procedurë administrative dhe vazhdim të lejeve dhe licensave* është shfuqizuar me Vendimin nr. 883/2020, i nxjerrë më 7 tetor 2020. Po ashtu, ministri i MPB-së ka njoftuar: “*Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në bazë të evidencës që posedon nga baza e të dhënave, nga data 6 korrik 2020 e deri me datën 20 shtator 2020, ka nxjerrë gjithsej nëntëqind e trembëdhjetë (913) vendime nga fushëveprimi i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim.*”
  19. Avokati i Popullit konsideron se në këtë rast përgjigjja e MPB-së nuk qe e plotë, sepse MPB-ja ka dhënë informacion të përgjithshëm për të gjitha rastet që kishte vendosur Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim, mirëpo nuk kishte dhënë informacione nëse ka ndonjë rast tjetër, përveç rastit të z. Ma, që gjatë kësaj periudhe, përkatësisht prej datës 6 korrik 2020 e tutje, palëve u është kërkuar plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm për lejimin apo vazhdimin e leje qëndrimit të përkohshëm.

## SFONDI LIGJOR

### 20. Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24 [Barazia para Ligjit].

*“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*

*2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”*

Neni 36 [E Drejta e Privatësisë]

*“1. Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.”*

### 21. Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Neni 8 [Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme]

*“1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave.”*

Neni 9 [Parim i administratës së hapur] përcakton:

*“1. Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.*

*2. Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t'u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj.”*

Neni 11 [Parimi i informimit dhe ndihmës aktive] përcakton:

*“1. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që mosdija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit. Organi publik, në veçanti, informon palën për të drejtat dhe detyrimet e saj në procedurën administrative, si dhe për pasojat juridike të veprimeve a mosveprimeve të saj gjatë kësaj procedure.*

*2. Organi publik, gjatë procedurës administrative, ndihmon që palët të mbrojnë dhe realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre juridike, sa më lehtë të jetë e mundur por pa cenuar të drejtat dhe interesat juridik të personave të tjerë.*

*3. Organi u siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth:*

*3.1. mënyrës si të fillojnë një procedurë të caktuar administrative, brenda fushës përkatëse të kompetencës;*

*3.2. kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të*



*parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar, përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që duhen parashtruar;*

*3.3. afatit kohor për njoftimin e vendimit përfundimtar, si dhe 3.4. mjeteve juridike në dispozicion të palës dhe mënyrën e ushtrimit të tyre.*

*4. Detyrimi i organit publik për të dhënë informacion dhe ndihmë aktive, sipas këtij neni, konsiston në dhënien e informacionit të përgjithshëm, në mënyrën se si zakonisht interpretohen dhe zbatohen dispozitat mbi informatat e parapara në paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni, por nuk përfshinë ndihmën juridike për rastet individuale.”*

**22. Udhëzimin Administrative (QRK) nr. 01/2015 për Përbërjen, Detyrat, Përgjegjësitë dhe Procedurën e Vendimmarrjes së Komisionit të Ankesave për të Huajt**

Neni 12, paragrafi 2, përcakton :

*“Secili anëtar i Komisionit apo panelit mund të parashtojë pyetje apo të kërkojë komente nga pala ankuese lidhur me çfarëdo çështje ligjore ose faktike që ka të bëjë me ankesën.”*

Neni 12, paragrafi 3, përcakton:

*“Komisioni apo paneli mund të kërkojë prova shtesë lidhur me çfarëdo çështje që parashtrohet nga cila do palë gjatë procedurës.”*

**23. Vendimi i MPB-së nr. 159/2020, i datës 30 mars 2020, për shtyrje dhe pezullim të afateve në procedurë administrative**

Paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, përcakton:

*“1. Shtyhet afati ligjor për parashtrimin e kërkesave dhe pezullohet afati ligjor për vendosje në shkallë të parë për çështjet si në vijim:*

*[. . .]*

*1.2 lejeqëndrim të përkohshëm dhe të përhershëm për të huajt.”*

**24. Vendim i MPB-së nr. 731/2020, i datës 6 korrik 2020, për shtyrje dhe pezullim të afateve në procedurë administrative dhe vazhdim të leje dhe licensave**

Paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, përcakton:

*“ 1. Pezullohen të gjitha shërbimet me palë në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migrim, si dhe shtyhet afati ligjor për parashtrimin e kërkesave, dhe pezullohet afati ligjor për vendosje në shkallë të parë, për çështjet si në vijim:*

*1.2. lejeqëndrim të përkohshëm, të përhershëm, viza C dhe viza D për të huajt.”*

## ANALIZA DHE KONSTATIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

### Shkeljet e kryera nga Divizioni për të Huaj i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim, në kuadër të MPB-së (shkalla e parë)

25. Mosrespektimi i Vendimit Nr. 731/2020, i datës 6 korrik 2020, i ministrit të Punëve të Brendshme/Koordinatorit të Grupit Ndërinstitucional të Menaxhimit të Incidenteve, vendim ky që ka pezulluar apo shtyrë të gjitha afatet për kërkesat për leje qëndrimi të përkohshëm. Ky vendim vetëm e ka konfirmuar pezullimin e mëhershëm të këtyre afateve, sipas Vendimit Nr. 159/2020 të ushtruesit të detyrës së ministrit të MPB-së/Koordinatorit të Grupit Ndërinstitucional të Menaxhimit të Incidenteve, më 30 mars 2020.
26. Shkelja e nenit 11 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton: *“Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që mosdija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit. Organi publik, në veçanti, informon palën për të drejtat dhe detyrimet e saj në procedurën administrative, si dhe për pasojat juridike të veprimeve a mosveprimeve të saj gjatë kësaj procedure”*, Avokati i Popullit vëren se zyrtarët e Divizioni për të Huaj i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim, në kuadër të MPB-së nuk e kanë njoftuar paraprakisht palën se, me gjithë shtyrjen dhe pezullimin e afateve përkatëse sipas Vendimit Nr. 731/2020, ata do të nxjerrin vendim për rastin e tij. Mosinformimi i palës paraqet shkelje të nenit 11 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të cituar më lart. Po ashtu, kjo paraqet shkelje të nenit 8 [Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme] dhe të nenit 9 [Parimi i administratës së hapur] të këtij ligji. Meqenëse afatet përkatëse ishin shtyrë apo pezulluar, Divizioni për të Huaj i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim, në kuadër të MPB-së, e kishte obligim ligjor për ta informuar z. Ma se mosplotësimi i kërkesës deri në një datë të caktuar do të kishte pasojat juridike të 1) refuzimit të leje qëndrimit dhe 2) largimit të tij nga territori i Republikës së Kosovës, me ndalim rihyrjeje për 1 vit. Në vend të kësaj, vendimet për refuzimin e leje qëndrimit dhe për largim vullnetar janë nxjerrë në mënyrë krejtësisht të papritur, të paparalajmëruar dhe, për këto arsye, edhe të paligjshme.
27. Sipas nenit 76, paragrafi 2, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative thuhet: *“Parashtruesit i lëshohet një vërtetim që dëshmon pranimin, datën, qëllimin e kërkesës si dhe listën e dokumenteve të bashkëngjitura, nëse ka të tilla.”* Pala nuk ka marrë asnjë vërtetim të tillë. Prandaj edhe për regjistrimin zyrtar të kërkesës, pala ka qenë krejt e painformuar, gjë që e thekson edhe një herë që vendimet e shkallës së parë kanë qenë krejtësisht të papritura.
28. Koncepti i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme në mbrojtjen e të drejtave subjektive është një koncept gjithëpërfshirës interpretimi në praktikën gjyqësore ndërkombëtare. Sipas GjEDNj-së (shih rastet *Kopecky kundër. Slovakisë*, Aktgjykimi i datës 28 shtator 2004, § 45-52; *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke* (dec.), nr. 39794/98, § 73, GJEDNJ 2002-VII), “pritshmëria e ligjshme” duhet



të jetë e një natyrë konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore dhe në akte ligjore. Në rastin aktual, pritja e ligjshme e ankuesit bazohet në dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në dy vendimet e MPB-së për shtyrjen dhe pezullimin e afateve, por edhe në e-mailin e zyrtarit të MPB-së, i datës 29 prill 2020, sipas të cilit ankuesi është siguruar se, në rrethana aktuale, mjafton vetëm paraqitja e kërkesës për leje qëndrimi, të cilën ankuesi e ka paraqitur më 7 prill 2020.

### **Shkeljet e kryera nga Komisioni i Ankesave për të Huaj (shkalla e dytë)**

29. Avokati i Popullit konsideron se vendimi i Komisionit të Ankesave, njëjtë si organi i shkallën e parë, është marrë në kundërshtim me Vendimin Nr. 731/2020, i datës 6 korrik 2020, madje nuk përmendet fare fakti se ekziston një vendim për shtyrje dhe pezullim të afateve në procedurë administrative dhe vazhdim të leje dhe licensave.
30. Vendimi i Komisionit të Ankesave për të Huaj e ka cituar si arsye për refuzimin e leje qëndrimit konstatimin që pala nuk ka dëshmuar që ka mjaft qarkullim bankar, në bazë të kontratës së punës dhe një pasqyre të llogarisë bankare. Mirëpo, gjatë seancës së Komisionit, ankuesi ka prezantuar një pasqyrë tjetër bankare, gjë që nuk është marrë parasysh nga Komisioni.
31. Me këtë, Komisioni i Ankesave ka shkelur nenin 11, par. 2, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton: "*Organi publik, gjatë procedurës administrative, ndihmon që palët të mbrojnë dhe realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre juridike, sa më lehtë të jetë e mundur por pa cenuar të drejtat dhe interesat juridik të personave të tjerë.*" Arsyeja e vetme që mbetet për refuzimin e leje qëndrimit është që pala nuk ka paraqitur një përkthim të diplomës universitare në ndonjërin nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës. Komisioni nuk e ka informuar ankuesin që diploma origjinale që ka paraqitur ai nuk është e besueshme pa u shoqëruar me përkthim.
32. Për të demonstruar se me të vërtetë ankuesit nuk i është ofruar ndihma në mënyrë që ai t'i realizonte të drejtat dhe interesat e veta, shihet në Procesverbalin e seancës së mbajtur më 15 shtator 2020, nga Komisioni i Ankesave për të Huajt, i cili më vonë është korrigjuar nga Komisioni me kërkesën e ankuesit, ku theksohet: "*Asnjë nga anëtarët e Komisionit nuk ngriti asnjë pyetje a shqetësim, lidhur me dokumentet e prezantuara nga z. Ma. Po ashtu, asnjë anëtar nuk i kërkoi z. Ma ndonjë sqarim lidhur me këto dokumente.*"<sup>1</sup>
33. Siç përcaktohet qartë në nenin 11, çdo organ publik e ka për detyrë t'i ndihmojë palët t'i realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre juridike. Madje, Komisioni ka kompetencat eksplicite për t'i bërë pyetje palës dhe për t'i kërkuar prova shtesë nëse nuk mjaftojnë ato që janë prezantuar. Sipas Udhëzimit Administrative (QRK) Nr. 01/2015 për

<sup>1</sup> Procesverbali i mbledhjes së Komisionit të ankesave, mbajtur më 15 shtator 2020, emaili i kryesuesit të Komisionit, i datës 22 tetor 2020, sipas të cilit Komisioni ka aprovuar ndryshimet në procesverbalin e seancës së mbajtur më 15 shtator 2020, me tekstin e theksuar më sipër.



Përbërjen, Detyrat, Përgjegjësitë dhe Procedurën e Vendimmarrjes së Komisionit të Ankesave për të Huajt, neni 12, paragrafi 2, përcakton: “*Secili anëtar i Komisionit apo panelit mund të parashtrijë pyetje apo të kërkojë komente nga pala ankuese lidhur me çfarëdo çështje ligjore ose faktike që ka të bëjë me ankesën*”; dhe neni 12, paragrafi 3, përcakton: “*Komisioni apo paneli mund të kërkojë prova shtesë lidhur me çfarëdo çështje që parashtrihet nga cila do palë gjatë procedurës.*” Kjo do të thotë se Komisioni ka dështuar që ta respektojë parimin ligjor të ndihmës administrative. Komisioni ka pasur mundësi për të kërkuar sqarime apo prova shtesë, qoftë përkthimin e diplomës, qoftë informatat nëse z. Ma ka dëshmi për mjete të tjera financiare.

### **Shkeljet e së drejtës për të mos u diskriminuar dhe të së drejtës së privatësisë**

34. Avokati i Popullit nuk ka mundur që të mos e vërejë faktin se ankuesit i është shkelur e drejta për të mos u diskriminuar si dhe e drejta e privatësisë. Kjo nisur nga fakti se për rastin e ankuesit kanë raportuar edhe disa media, duke përdorur gjuhë diskriminuese. Për më shumë, vërehet se rrjedhja në publik e vendimeve që janë nxjerrë në rastin e ankuesit, janë vendime individuale që përmbajnë të dhëna personale.
35. Më 8 shtator 2020, *Periskopi* publikoi një shkrim me titullin: “*I ‘varfëri’ Albin Kurti vazhdon të paguaj këshilltarin me prejardhje kineze Tienmu Ma i cili ilegalisht po qëndron në Kosovë*”<sup>2</sup> (theks i shtuar). Ky shkrim publikon foto të të dy vendimeve të shkallës së parë që janë nxjerrë në rastin e z. Ma. Rrjedha e këtyre informatave në media dhe theksimi i karakteristikave të mbrojtura sipas nenit 1 të Ligjit nr. 05/L -021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përbëjnë diskriminim mbi bazën e etnisë dhe të racës.
36. Avokati i Popullit, ka vërejtur se më 24 shtator 2020, *Gazeta Express* publikoi një shkrim me titullin: “*Kush është Tienmu Ma, këshilltari i Kurtit të cilin ministria e Veliut po e përzë nga Kosova*”<sup>3</sup>, ku, në brendi të shkrimit shefi i Kabinetit të ministrit të MPB-së, thotë: “*Komisioni ka prurë vendim që nuk i ka plotësua kushtet për ta marrë lejeqendrimin në bazë të rregullave. Vendimi del nesër, ose këto ditë*”. Nga kjo, qartazi shihet se deklarimi nga ana e shefit të kabinetit të MPB-së, gjegjësisht vetë ministrit, e cila ka vendosur si organ i shkallës së parë për rastin në fjalë, konsiderohet tejkalim i kompetencave dhe autorizimeve që MPB dhe shefi i kabinetit të ministrit të MPB kanë pasur në atë fazë. Dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative saktësisht i përcaktojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të shkallës së parë dhe shkallës së dytë në trajtimin dhe vendimmarrjen e çështjeve në procedurën administrative.
37. Për më tepër, shefi i kabinetit të Ministrit të MPB-së është deklaruar publikisht për

<sup>2</sup> <https://www.periskopi.com/i-varfe%CC%88ri-albin-kurti-vazhdon-ta-paguaj-ke%CC%88shilltarin-me-prejardhje-kineze-tienmu-ma-i-cili-ilegalisht-po-qe%CC%88ndron-ne%CC%88kosove%CC%88dok/>

<sup>3</sup> <https://www.gazetaexpress.com/kush-eshte-tienmu-ma-keshilltari-i-kurtit-te-cilin-ministria-e-veliut-po-e-perze-nga-kosova/>



vendimin e Komisionit të Ankesave për të Huajt, ndërsa pala ende nuk ishte njoftuar në asnjë mënyrë lidhur me vendimin. Në anën tjetër, vendimet e Komisionit janë jopublike. Po ashtu, seancat janë me dyer të mbyllura. Së këndejmi, Avokati i Popullit vlerëson se veprime të tilla përbëjnë shkelje të së drejtës së privatësisë së z. Ma.

38. Më 25 shtator 2020, ashtu sikur që është paralajmëruar nga shefi i kabinetit të Ministrit të MPB-së, vendimi i Komisionit është publikuar përmes një shkrimi të *Gazeta Infokus*, me titullin: “*Refuzohet ankesa e Tomë Gashit, komisioni qeveritar aprovon dëbimin e këshilltarit të Albin Kurtit (Dokumente)*”.<sup>4</sup> Në këtë shkrim, vendimi i Komisionit të Ankesave publikohet në tërësi.
39. Duke u nisur nga analiza dhe vlerësimet e sipërpërmendura, Avokati i Popullit konstaton se në rastin e z. Tienmu Ma ka pasur shkelje të:
- së drejtës për të mos u diskriminuar;
  - së drejtës së privatësisë; dhe
  - Parimeve të përgjithshme të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme; parimi i administratës së hapur; dhe parimi i informimit dhe i ndihmës aktive.
40. Gjithashtu, Avokati i Popullit e konsideron të rëndësishme të theksojë se ky rast, është përcjellë nëpërmjet portaleve, përfshirë rrjetet sociale, me një gjuhë me elemente të nxitjes së urrejtjes në baza racore dhe etnike. Diskursi jotolerues, shpesh përtej kufijve të lirisë së shprehjes, që ka cak një grup a individ, mbi baza të ndryshme diskriminimi, po ndodhë gjithnjë e më shpesh edhe në formatin publik dhe në raste si ky i z. Tienmu Ma, po shpërfaqet në mënyrë jashtëzakonisht shqetësuese dhe të papranueshme.

### REKOMANDIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

Në bazë të konstatimeve të sipërpërmendura dhe në përputhje me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 27 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon:

- Komisionit të Ankesave për të Huajt ndryshimin e Vendimit nr. 116/2020, të datës 21 shtator 2020, me të cilin e ka refuzuar ankesën e paraqitur nga ankuesi më 2 shtator 2020, kundër vendimeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme – Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim – Divizioni për të Huajt, në mënyrë që çështja e z. Tienmu Ma të rishqyrtohet, duke respektuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi, me qëllim të përmirësimit të mangësive të cilat kanë shkaktuar shkeljet e konstatuara nga Avokati i Popullit.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e*

<sup>4</sup> <https://gazetainfokus.com/refuzohet-ankesa-e-tome-gashit-komisioni-qeveritar-aprovon-debimin-e-keshilltarit-te-albin-kurtit-dokumente/>



*Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.*

Me nderime,

  
Naim Qelaj  
Avokat i Popullit